



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	06/17			
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Komuna e Pejës - Parashtruesit të ankesës “ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K.” me seli në Pejë			
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP			
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit		<u>Bullatovci</u>	
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar “ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K.” me seli në Pejë, me numër protokollit 06/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës” Lot 1, me nr. të prokurimit 635/16/113/221, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Pejës.			
Lokacioni:		Prishtinë	Data:	25.01.2017
PËR AKTIVITET				X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR				X
PËR KOMENTE				X
PËR INFORMIMIN TUAJ				X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës” Lot 1, me nr. të prokurimit 635/16/113/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues “ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K.” me seli në Pejë, me numër protokollit 06/17.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Bulldozeri</i>	16.01.2017	17.01.2017	25.01.2017
Nënshkrimi i ekspertit	<i>data e autorizimit të eksp.</i>	<i>data e fillimit të ekspertizës</i>	<i>data e dorëzimit të raportit</i>

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 10 janar 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE “ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K.” me seli në Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës” Lot 1, me nr. të prokurimit 635/16/113/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës. Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: “ER-LIS SH.P.K.& VE-MOR SH.P.K.” me seli në Pejë

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 1, Qëllimi;
- Shkelje e nenit 6 të LPP-së, Ekonomiciteti dhe Efektivitetit;
- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;
- Shkelje e nenit 54 të LPP-së, Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Shkelje e nenit 60 të LPP-së, Kriteret për Dhënie të Kontratës;
- Shkelje e nenit 69 të LPP-së, Aftësitë teknike dhe/ose profesionale; ;
- Shkelje e nenit 3.4 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik;
- Shkelje e nenit 24 paragrafi 1 pika C, Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, “Grupi i operatoreve ekonomik”;
- Shkelje e nenit 17 paragrafi 1 i Rregullores së Prokurimit Publik.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

- AK nuk e ka respektuar Ligjin e Prokurimit Publik ka vepruar njeanëshem edhe pse Konzorciumi “ER-LIS & VE-MOR” i ka përmbushur të gjitha Kërkesat e kërkuara ne dosjen e tenderit dhe ne FDT. Kurse Operatoret e propozuar për shpërblim me Kontratë kanë dështuar të përmbushin Kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe sqarimet-informatat e AK te datës 13 dhe 14.12.2016 lidhur me këtë Aktivitet të Prokurimit.

Kërkesat e dosjes së tenderit janë:

9.1 Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale:

1. Shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit 2013,2014 dhe 2015 për LOTO 1 ka me qene jo me pak se 140,000.00€. LOTO 2 ka me qen jo me pak se 200,000.00€ LOTO 3 ka me qen jo me pas se 45,000.00€.

2. € 1. Lista e Mjeteve të punës për (LOT1)- (LOT-2)-(LOT-3)

9.2 Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE-original, ku përfshihen titujt e projekteve,numri,data e kontraktimit dhe vlera, të bashkangjitur te jen referencat ose procesverbalet te pranimit. Për LOTO-1, LOTO-2,LOTO-3

2. Lista e pajisjeve - mjeteve te punës qe OE duhet ti ketë në dispozicion (në pronësi te vetën) të dëshmohen me kopje te librezave, deklarate doganore apo ndonjë dëshmi tjetër, të specifikuar për LOTO" për të cilën paraqet kërkesë.

Nr. MAKINERIT LOT- 1, SASIA

1 Kamion borëpastrues 3.

2 Makineri të lehtë për pastrimin e 1.

trotuareve dhe Shesheve

3. Makineri të lehtë (Skip) për 1.

ngarkimin e borës në kamion

4. Makineri të rëndë (Ultë) dhe këtë 1. makineri nuk mund ta shfrytëzoj për mirëmbajtjen dimërore

Nr. MAKINERIT LOT-2 SASIA

1 Kamion borëpastrues 3.

2 Makineri të lehtë (Skip) për 1.

ngarkimin e borës në kamion:

3. Makineri të rëndë (Ult) dhe këtë 1.

makineri nuk mund ta shfrytëzoj për mirëmbajtjen dimërore

Nr. MAKINERITE LOT-3 SASA

1 Kamion borëpastrues 3

2 Makineri të rëndë (Ult) dhe këtë 1.

makineri nuk mund ta shfrytëzoj për mirëmbajtjen dimërore

Vrejtjel: Preferohet që O.E gjatë gjithë kohës së mirëmbajtjes dimërore makineritë ta ketë në Rugovë për shkak të reshjeve të mëdha dhe të shpeshta dhe se orët e punës do të llogariten vetëm orët efektiv dhe nuk do të llogariten orët nga vendndodhja e operatorit deri tek rrugët që do të mirëmbahen.

Vërejtje 2: A.K. për shkak të efikasitetit të punëve O. E do ti shpërblejë vetëm me një LLOT

- Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni Vlerësues kanë bërë shkelje duke nënshkruar raportet e vlerësimit për secilin LOT dhe për secilin OE që ka konkurruar dhe atë që të gjithë (me përjashtim të 1 OE) duke i shpallur si të përgjegjshëm, duke mos përfill kërkesat e Dosjes së tenderit dhe informatat shtesë (s qarimet) e bëra nga vetë AK lidhur me dëshmitë e kërkuara dokumentare. Ku kërkohet që makineria e përdorur për një LOT nuk mund të përdoret për LOTIN tjetër.

Sqarim: OE kane konkurruar ne dy ose ne tri Lote dhe për të gjitha llotet komisioni i ka vlerësuar si të përgjegjshëm d.m.th OE për dy/tri Lote duhet të kenë pajisje (në pronësi):

1. Kamion borëpastrues: 6 Cope për dy (2) Lote /9 për tri (3) Lote 2.
2. Makine e lehte për pastrim të trotuareve dhe shesheve 1 cope.
3. Makineri të lehtë (Skip) për ngarkimin e borës në kamion 2 copë.
4. Makineri të rënd (Ultë) dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoj për mirëmbajtjen dimërore 2 copë/3.

Te gjitha këto janë sqaruar në sqarimet e pranuar nga AK-ja

- Dëshmi shkresat nga Autoriteti kontraktues dat. 13 dhe 14.12.2016

Gjatë qasjes në dokumente Zyrtare kemi hasë në parregullsi të cilat AK nuk i ka cilësuar si të tilla: OE te propozuar për Lot 1 i mungon:

1. Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik 11.1 pika C. Ne kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit e po ashtu në kundërshtim me UO 24. 1, C

2. Dëshmia e kërkuar dokumentare 9.2

Pika 1. Lista e shërbimeve të ngjajshme e vërtetuar nga OE origjinal, ku përfshihen titujt e projekteve. Për LOTO -1, LOTO - 2 , LOTO- 3

OE nuk e përmbush dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

3. Pika 2. Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë në dispozicion (në pronësi të vetën) ,të specifikuar për LOTO”n për të cilën paraqet kërkesë.

Po ashtu OE dështon të dëshmoj listën e pajisjeve të specifikuara në Dosjen e Tenderit

- Pra OE e propozuara për Kontratë dështojnë të paraqesin dokumentet e kërkuara nga AK si dhe në kundërshtim me LPP-në, Komisioni Vlerësues nënshkruan Raportin e Vlerësimit i cili nuk është i vërtet, kurse AK i shpallë si të përgjegjshme përkundër Informatave shtesë dhe kërkesave të dosjes së tenderit të bëra nga vetë AK.
- Po ashtu edhe në Kërkesën për Rishqyrtim kemi njoftuar Autoritetin Kontraktues për shkeljet e bëra gjatë vlerësimit, në përgjigjen e AK anashkalon çdo përgjigje e cila ka të bëjë me kërkesat e dosjes së tenderit.

- Nga Zyrtarët e Prokurimit kemi edhe dëshmi me shkrim për të gjeturat e operatorëve të propozuar për kontratë por Çuditërisht AK nuk ndërmerr asgjë për të respektuar LPP-në
- Komisioni Vlerësues mendoj që ka bërë shkelje, (duke nënshkruar Deklaratën nën Betim) morale e ndoshta edhe penale lidhur me nënshkrimin e vlerësimit të rrejshëm ose të gabuar në kundërshtim me:

Nenin 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.

2. Po ashtu AK ka bërë shkelje të nenit Neni 16 paragrafi 2,3. të RREGULLORES SE PROKURIMIT PUBLIK

Krijimi i Komisioneve të Vlerësimit

Ne dosjen e Tenderit AK :

Vërejtje 2:4. A. K për shkak të efikasitetit të punëve O. E do të shpërblejë vetëm me një LLOT.

Që do të thotë se të gjithë OE do të shpërblehen vetëm me një Kontratë , e në rastin tonë nëse njëri nga OE e propozuara për Kontratë është i papërgjegjshëm atëherë në shpërblehemi me kontratë.

PROPOZIMI

OSHP-së i propozojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga OE “ER-LIS &VE-MOR” PEJË lidhur me aktivitetin e prokurimit Nr. PE635-16-113-2-2-1 Sa i përket tenderit për: ”MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE NE KOMUNEN E PEJES” Lot1,Lot2,Lot3

të nxjerr vendim:

APROVOJË si të bazuar ankesën e OE “ER-LIS sh.p.k.& VE-MOR-sh.p.k.”

ANULOJ: Vendimin - Njoftimi për DHENIE TE KONTRATES

URDHËROHET: AK, KOMUNA E PEJES ta kthej në RI Vlerësim Aktivitetin e Prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës” Lot 1, me nr. të prokurimit 635/16/113/221.

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues(N.22.1).....	07.11.2016
Data e njoftimit për kontratë (N. 40)	05.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-.....	Procedura e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16):	Shërbime /e mesme
Vlera e përlogaritur për këtë prokurim (N.15-19):	Lot 1- 90,000.00 € 36muaj
Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK (N.9):	
Afati kohor për pranimin e projekteve (gjithsejtë ditë):	15.12.2016

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60):	Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët.
Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri (N.65-69):	
1. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.	
Dëshmitë dokumentare:	
2. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vëlosur nga tenderuesi(duhet dorëzuar së bashku me tenderin).	
Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet .	
Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon:	
a. Për situatën referuar nën 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, <u>vërtetimi i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.</u>	

- b. Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

Kërkesat përshatshmërisë profesionale (N. 66):

- Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
- Regjistrimi i TVSH;
- Regjistrimi i Numrit Fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
- Certifikata e TVSH- kopje
- Certifikata e numrit fiskal- kopje

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së)

- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor OE gjatë tri viteve (2013, 2014,2015) për LOTO 1, ka me qene jo me pak se 180,000.00 €.
- Sigurimi i tenderit në vlerë 4,000.00€
- Sigurimi i ekzekutimit 10%, vlerës së kontratës

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare që dëshmon transaksionet financiare për tri vitet e fundit 2013, 2014 dhe 2015, për LOTO -1.

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së)

- Shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit 2013,2014 dhe 2015 për LOTO 1, ka me qene jo me pak se 140,000.00 €.
- Lista e Mjeteve të punës për (LOT 1)- (LOT-2)-(LOT-3

Dëshmitë e kërkuara dokumentare

- Lista e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE-origjinal,ku përfshihen titujt e projekteve, numri,data e kontraktimit dhe vlera, të bashkangjitur të jen referencat ose procesverbalet të pranimit. Për LOTO -1, LOTO -2 ,LOTO- 3.

- Lista e pajisjeve – mjeteve te punës qe OE duhet ti ketë në dispozicion(në pronësi te vetën)të dëshmohen me kopje te librezave, deklarate doganore apo ndonjë dëshmi tjetër, të specifikuar për LOTO’ për të cilën paraqet kërkesë.

Nr.	MAKINERITLOT-1	SASIA
1	Kamion borëpastrues	3
2	Makineri të lehtë për pastrimin e trotuareve dhe shesheve	1
3	Makineri të lehtë (Skip) për ngarkimin e borës në kamion	1
4	Makineri të rëndë (Ultë)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirëmbajtjen dimërore	1

Nr.	MAKINERITLOT-2	SASIA
1	Kamion borëpastrues	3
2	Makineri të lehtë (Skip) për ngarkimin e borës në kamion	1
3	Makineri të rëndë (Ultë)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirëmbajtjen dimërore	1

Nr.	MAKINERITLOT-3	SASIA
1	Kamion borëpastrues	3
2	Makineri të rëndë (Ultë)dhe këtë makineri nuk mund ta shfrytëzoi për mirëmbajtjen dimërore	1

Vrejtje1: Preferohet që O.E gjatë gjithë kohës së mirëmbajtjes dimërore makineritë ta ketë në Rugovë për shkak të reshjeve të mëdha dhe të shpeshta dhe se orët e punës do të llogariten vetëm orët efektiv dhe nuk do të llogariten orët nga vendndodhja e operatorit deri tek rrugët që do të mirëmbahen.

Vërejtje 2: A.K për shkak të efikasitetit të punëve O.E do ti shpërblejë vetëm me një LLOT

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi Lot 1
1.	“ER-LIS&VE-MOR”	Pejë	79,212.00€
2.	“KE-LUANI”	Pejë	34,776.00€
3.	“HORN-CO&ENGINEERING GROUP”	Deçan	78,246.00€
4.	“DOREARTI&GRANITI&LINDI MARKINGS”	Pejë	24,150.00€
5.	“LIKA TRADE”	Deçan	28,980.00€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 4 (katër) OE, ku është lexuar shifra e operatorit ekonomik.

Komisionet vlerësues pran AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N. 59).

Autoriteti kontraktues, me dt. 16 dhjetor 2016, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, si në vijim:

- Shemsedin Abazi, Kryetar i komisionit
- Beqir Haxhia, Anëtar
- Milot Gashi, Anëtar

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimit:..... 16.12.2016

Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N. 41):.....21.12.2016

Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):.....28.12.2016

Raporti i komisionit vlerësues

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstaton se 5 (pesë) operator ekonomik që kanë ofertuar, në aktivitetin e prokurimit **“Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës” Lot 1**, me nr. të prokurimit 635/16/113/221, ku të gjithë operatorët ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Duke u bazuar në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe duke pas për bazë kriterin për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, komisioni i vlerësimit rekomandon që OE **“DOREARTI&GRANITI&MARKINGS”** nga Peja, të shpallet fitues në aktivitetin e prokurimit **“Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës” Lot 1**, me nr. të prokurimit 635/16/113/221, oferta e këtij operatori ekonomik është 72,450.00€.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit “**Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës**” Lot 1, me nr. të prokurimit 635/16/113/221, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 36 muaj, shërbime, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi: Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-së, ekspertja shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues është i obliguar që fondet publike dhe burimet publike të përdorë në mënyrë ekonomike, duke pasur parasysh qëllimin dhe lëndën e kontratës, prandaj autoriteti kontraktues konform nenit 6 të LPP-së, ka përgjegjësi për mos shfrytëzim të drejt fondeve publike dhe burimeve publike.

Sqarimi: Nr. 3

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti ka bërë shkelje të nenit 54 të LPP-së, ekspertja shqyrtues bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se nuk qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye se autoriteti kontraktues për mes letrës standarde kërkesë për sqarim të tenderit llogaritje e gabuar dhe letër standarde për tenderuesin/kandidatin e eliminuar, me dt. 22.12.2016, e ka njoftuar operatorin ekonomik ankues ku ndër të tjera thuhet: *Komisioni vlerësues gjatë ekzaminimit të ofertës së suaj për Lot 1 ka hasur me gabime aritmetikore në pozicionin nr. 1 i paramases dhe parallogarit.....Edhe pse oferta e juaj është zvogëluar për 1,255.80€, prapë nuk është oferta me e lirë në këtë Lot.*

Sqarimi: Nr. 4

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “*Gjatë qasjes në dokumente zyrtare kemi hasë në parregullsi të cilat AK-ja nuk i ka cilësuar si të tilla: OE te propozuar për Lot 1 i mungon: Deklarata e Konzorciumit sipas FDT-së. Krijimi i një grupi te operatorëve ekonomik 11.1 pika C. Ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit e po ashtu ne kundërshtim me UO 24. I, C*”, ekspertja shqyrtuese sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye se konsorcium i rekomanduar për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit si dëshmi ka ofruar marrëveshjen e konsorcium se do të veprojnë si ndërmarrje e përbashkët në kryerjen e punëve, e nënshkruar dhe e vulosur nga 3 (tre) anëtarët e grupit, si dhe Deklaratat ku secili anëtar i grupit deklarojnë: deklaroj nën përgjegjësin time të plotë se jam i obliguar si bashkërisht dhe veç e veç për tenderin e grupit dhe nëse kontrata i jepet grupit për ekzekutimin e kontratës.

Andaj, bazuar në këtë shihet qarte se mungon deklarata e anëtarëve të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit, ashtu siç kërkohet në nenin 27.1 pika c. të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik –A01, dt. 01. nëntor 2016.

Sqarimi: Nr. 5

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: *“OE nuk e përmbush dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kërkesave të dosjes së tenderit për kërkesën: Pika 1. Lista e shërbimeve të ngjashme e vërtetuar nga OE origjinal, ku përfshihen titujt e projekteve. Për LOTO -1, LOTO - 2 , LOTO- 3, ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës si dëshmi ka ofruar listën e punëve të kryera, të bashkangjitur me kontrata dhe referenca, të vulosur dhe nënshkruar në kopje, e jo origjinal ashtu siç është kërkuar në nenin 9.2 të FDT-së, mirëpo ekspertja shqyrtuese sqaron se autoriteti kontraktues me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike është dashtë të veprave konform nenin 72 të LPP-së.*

Ndërsa sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ku thuhet: *“Po ashtu OE dështon të dëshmojë listën e pajisjeve të specifikuar në Dosjen e Tenderit”,* ekspertja shqyrtuese sqaron se operatori ekonomik-konsorcium i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar si dëshmi listën e pajisjeve që ka në pronësi, mirëpo nuk e ka specifikuar Lotin.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e **“Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Pejës” Lot 1,** me nr. të prokurimit 635/16/113/221, i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj vendimin njoftim për dhënie të kontratës, të dt. 21 dhjetor 2016, dhe lëndën ta kthejë në Rivlerësim.